

V E N D I M
Nr.39, datë 26.1.2001

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 4 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në varësi me numrin e popullsisë, shtrirjen territoriale dhe nivelin e zhvillimit ekonomik-social, kategorizimi i qarqeve, i bashkive e i komunave, për efekt page të punonjësve, bëhet nga ministri i Pushtetit Lokal dhe miratohet nga kryeministri.”.

2. Në lidhjen II-A “Shtesat mbi pagë për funksione drejtuese”, në kreun II “Shtesa të tjera”, pas pikës 22 shtohet pika 23, me këtë përmbajtje:

“24. Drejtuesve dhe specialistëve të Drejtorisë së Kontroll-Mbikëqyrjes dhe Drejtorisë së Shpronësimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për natyrë të veçantë pune u jepet një shtesë mbi pagën bazë në masën 30 për qind.”.

3. Në lidhjen II-A “Shtesa mbi pagë për funksione drejtuese”, në kreun II “Shtesa të tjera”, bëhen këto plotësime:

“Në fund të pikës 3 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në prefektura, revizorët (inspektorët e kontrollit) 35-40 për qind dhe drejtuesve të tyre 10 për qind. Këta punonjës nuk përfitojnë shtesën mbi pagë, të përcaktuar në pikën 11 të kësaj lidhjeje.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta